



PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS
THE ALBANIAN CHRISTIAN DEMOCRATIC PARTY OF KOSOVA
ALBANISCHE CHRISTLICH-DEMOKRATISCHE PARTEI VON KOSOVA
PARTITO ALBANESE DEMOKRISTIANO DI KOSOVA
LE PARTI ALBANAIS DEMOKRATE-CHRETIEN DE LA KOSOVA

Organ i aktivistëve dhe intelektualëve demokristian në Vjenë

BULETIN INFORMATIV Nr. 2- shtator 2010

del një herë në 3 muaj

shpërndarja: pa pagesë

„Dielli i shqiptarëve lind në perëndim” (Faik Konica)

DIELLI DEMOKRISTIAN



Shkrime: E ardhmja e Kosovës
Intelektuali ynë
Sëmundja e sheqerit
Shënime nga Auschwitz-i

1

Info nga PSHDK
Ditët e Nënë Terezës në Vjenë
Prezentim libri: nga Xhenc Bezhi

Intervista
Shoqata „Nënë Tereza” nga Baden (Austri)
Këndi kulturor



Vlerat demokristiane-pjesë të vlerave universale të njerëzimit

Qytetërimi bashkëkohor bazohet në vlerat e lirisë, barazisë, dinjitetit dhe respektit për të gjithë njerëzit pa dallim race, kombi, gjuhe apo besimi. Në këtë relacion edhe demokristianët vazhdojnë të jenë pjesë e kësaj tradite, kulture dhe vlere duke bërë që bashkëjetesa mes kombeve dhe feve të ndryshme të marrë përmasa të dashurisë, paqes, solidaritetit dhe humanizmit. Duke qenë pjesarë të spektrit të djathtë politik në skenën kosovare që nga dekompozimi i ish sistemit monist, ne kemi zhvilluar aktivitete në planin kombëtar dhe ndërkombëtar për lirinë, demokracinë dhe Pavarësinë e Kosovës, të gjitha këto në kontekstin e integritetit në familjen e madhe perëndimore.

FJALA E REDAKSISË

Të nderuar lexues,

Ju tashmë keni në dorë numrin e dytë të revistës „DIELLI DEMOKRISTIAN”, i cili është organ i aktivistëve dhe intelektualëve demokristian në Vjenë/Austri dhe botimi i të cilit realizohet nga këshilli redaktues i saj. Ky numër koïncidon me 100 vjetorin e lindjes së Nënë Terezës. Demokristianët janë në vulgun e aktiviteteve për shënimin e krenimit të këtij përvjetori të madh të nënës më të madhe që njohu bota bashkëkohore deri më tani. Kudo, në Prishtinë, Tiranë, Shkup, Graz e Vjenë ne po kontribuojmë në promovimin e jetës dhe veprës së kësaj nëne shqiptare që i dha humanizmit njerëzor aq shumë dashuri dhe paqe. Pos kësaj në tre muajt e fundit kishte dhe zhvillime tjera pozitive në skenën politike shqiptare, sidomos frytdhënës ishte kuvendi i jashtëzakonshëm i Partisë Shqiptare Demokristiane të Kosovës-PSHDK, i mbajtur me 19 qershor në Prishtinë, në të cilin delegatët zgjodhën kryetar të ri të saj intelektualin e mirënjohur Prof. Dr. Marjan Demën. Me daljen e numrit të dytë të revistës „DIELLI DEMOKRISTIAN” po vazhdon vendosja e një ure të re komunikimi mes anëtarëve, simpatizantëve, aktivistëve dhe intelektualëve demokristianë, sidomos në veçanti në Vjenë dhe në përgjithësi në Austri. Në këtë botim, ju do të gjeni shumë materiale me interes për rrjedhat e përgjithshme në shoqëri, jetën politike në Kosovë dhe diasporë. Këtu poashtu do të gjeni edhe informacione lidhur me organizimet dhe aktivitetet e ndryshme, me fokus të veçantë në programin „Ditët e Nënë Terezës në Vjenë” të përgaditur dhe implementuar nga Misioni Katolik Shqiptar në Vjenë. Për më tepër, ju mund të na shkruani lidhur me pyetjet, vërejtjet dhe sugjerimet tuaja në adresën e e-mail-it: dielli-demokristian@hotmail.com të cilave do tu pëgjigjemi në numrin e radhës të kësaj reviste, e cila pritet të dalë prapë në dhjetor të këtij viti. Këshilli redaktues falënderon të gjithë ata që ndihmuan në botimin e kësaj reviste periodike, e në veçanti ata që dërguan shkrimet e tyre, si dhe mbështetësit tanë moral. Ky numër është pëpiluar, dizajnuar dhe botuar në saje të punës dhe angazhimit vullnetar të aktivistëve tanë pa asnjë kompenzim financiar, dhe si i tillë do shpërndahet në adresat elektronike të lexuesve tanë në të katër anët e botës.

Lexim të këndshëm!

Këshilli redaktues:

Kristina Pjetri
Mark Gjuraj
Vilson Kola
Lush Neziri
Mark Marku

Bashkëpunutorë të jashtëm:

Hazir Mehmeti
Agron Shala
Anita Marku
Shtjefën Daka
Zef Ndrecaj
Valentina Pjetri

“Me gjak jam shqiptare; me nënshtetësi, indiane. Përsa i përket besimit, jam murgeshë katolike. Sipas thirrjes, i përkas botës. Por zemra ime i përket plotësisht Zembrës së Krishtit”.

Nënë Terezës, me shtat imcak, por me besim shkëmbor, të patundur, iu besua misioni të kumtonte dashurinë e etur të Jezusit për njerëzimin, veçanërisht për më të varfërit ndër të varfër. *“Hyji vijon ta dojë botën dhe na dërgon ty e mua për t’u shprehur të varfërve dashurinë dhe mëshirën e Tij”.* Në shpirtin e saj, përplot me dritën e Krishtit e me dashuri të zjarrtë për Të, kishte një dëshirë të vetme : *“Të shuante etjen e dashurisë së Tij për shpirtrat njerëzore”.*

Përmbajtja:

Ditët e Nënë Terezës në Vjenë.	3
Info nga PSHDK.....	4
Esej: E Ardhmja e Kosovës	5
Intelektuali Ynë	6
Intervista: Vilson Kola	7
Sëmundja e Sheqerit.....	8
Shënime nga Auschwitz-i.	9
Prezentim libri.....	10
Shoqata „Nënë Tereza“-Baden..	11
Këndi kulturor	11

Aktivitetet për shënimin e 100 vjetorit të lindjes së Nënë Terezës në Austri



Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 100 vjetorit të lindjes së Nënë Terezës, Misioni Katolik Shqiptar në Austri organizon

Ditët e Nënë Terezës në Vjenë (29 gusht-5 shtator 2010)

PROGRAMI:

- ❖ **Hapja e ekspozitës me fotografi, libra, piktura dhe punime tjera kushtuar Nënë Terezës**

e diele, 29 gusht nga ora 13:00 në: Meiselstraße 1, A - 1150 Wien

(P.S: kjo ekspozitë do të qëndroj e hapur deri me 5 shtator 2010, çdo ditë nga ora 9:00-19:00)

- ❖ **Takimi me fëmijët:**

lutje, uratë, adhurim dhe prezentim vizuel i jetës dhe veprës së Nënë Terezës
e mërkure, 1 shtator nga ora 20:00 në: Meiselstraße 1, A - 1150 Wien

- ❖ **Tribuna shkencore me temën „Nëna Terezja dhe shqiptarët“**
ligjërues, prof. dr. Anton Nikë Berisha

e enjte, 2 shtator nga ora 19:00 në UNI Wien-Fakulteti Juridik në: Schottenbastei 10-16, 1010 Wien

- ❖ **Koncerti me muzikë klasike shqiptare të kompozitorëve shqiptarë dhe të huaj**
performojnë studentët shqiptarë në akademinë e muzikës në Vjenë

e premte, 3 shtator nga ora 19:00 në: Meiselstraße 1, A - 1150 Wien

- ❖ **Sfilata me veshje kombëtare shqiptare dhe promovimi i dy librave për Nënë Terezën:**

„Thellimi në dashuri" dhe „Alfabeti i Nënë Terezës".

gjithashtu do të bëhet edhe promovimi i librave:

„PSHDK-bartëse e veprimtarive politike, kulturore e kombëtare në Austri" (Prekë Brahimi)

„Tregime nga Malësia e Gjakovës" (Xhenc Bezhi)

„Vizioni Blu" (Anton Marku)

e shtune, 4 shtator nga ora 20:00 në: Meiselstraße 1, A - 1150 Wien

- ❖ **Mesha solemne e përcjellur me program artistik**

e diele, 5 shtator nga ora 11:30 në: Meiselstraße 1, A – 1150 Wien

Për më shumë informacione:

Telefoni fix dhe Fax: +43 (0) 19837550

Mobil: +43 (0) 6767202545

E-Mail: donprenkola@hotmail.com

Web: www.misioni.at

INFO NGA PSHDK

Prof. Dr. Marjan Dema, kryetar i ri i Partisë Shqiptare Demokristiane të Kosovës-PSHDK



Me 19 qershor 2010 në lokalet e Pallatit të Rinisë në Prishtinë, Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës, mbajti Kuvendin e jashtëzakonshëm. Kuvendi ishte thirrur nga më se një e treta e delegatëve. Ai kaloi në frymë debatesh të shprehura me një tolerancë dhe politike. Pas numrimit të votave para të gjithë pjesëmarrësve në kuvend, prof. dr. Marjan Dema me 68 vota u zgjodh kryetar i ri i Partisë Shqiptare Demokristiane të Kosovës. Në punimet e Kuvendit morën pjesë edhe përfaqësuesit e Këshillit Qendror Zgjedhor të Kosovës.

Konferencë për shtyp e PSHDK

Të nderuara media të shkruara dhe elektronike,

me lejoni që në emër të anëtarësisë së PSHDK t'u përshëndes dhe t'u shpreh konsideratën time për rolin tuaj në avansimin e demokracisë në Kosovë. Pres bashkepunim të ngushtë dhe përmbytësor me ju. PSHDK tash përfundimisht e ka një adresë. Këtë adresë Kuvendi i Jashtëzakonshëm e vulosi me fitoren bindëse të forcave që duan ndryshime pozitive. Këto ndryshime do të vërehen që në muajt e parë të vjeshtës së këtij viti.

Ne do t'i japim fund përfundimisht përbuzjeve dhe abuzimeve që për dy vite i janë bërë këtij subjekti politik nga udhëheqësat e papërgjegjshëm. Do t'ia kthejmë dinjitetin e nëpërkëmbur për interesa mesquine të disa individëve të PSHDK dhe besimin në të. Ne do t'ia kthejë besimin votës së lirë të anëtarësisë së kësaj partie. Do të arrijmë të konsolidohemi dhe të jemi parti serioze ashtu siç na takon. Do ta rifreskojmë dhe begatojmë programin e kësaj partie me qasje evropiane, përkatësisht demokristiane, që të mirëpritemi nga partitë e njëjta në Evropë dhe do ta rishqyrtojmë statutin që të mos tallemi me vendimarrje dhe anëtarësi si deri më tash. Përmes këtij subjekti do të ndikojmë në ndryshimin e gjërave për të mirë në funksion të prosperitetit të Republikës së Kosovës. Pra, nga politikat e bëra nëpër kafene, me plot dallavere dhe zënka, do të kalojmë në program të mirëfilltë demokristian, i cili antarësinë e vete e llogaritë jo vetëm për zgjedhje në postë, por e respekton për prezantim të interesit dhe pikëpamjeve të tyre në institucionet demokratike të vendit dhe më gjërë. Do t'i japim fund abuzimit me besimin e dhënë përmes votës së elektoratit tonë. Do të angazhohemi që PSHDK të jetë letërnjoftim i Kosovës në Evropë. Gjithashtu do të angazhohemi në luftimin, me mjete demokratike, të dukurive negative që e kanë ngulfatur demokracinë kosovare. PSHDK do të përkrah bisedimet me Serbinë, por në asnjë mënyrë ato që kanë të bëjnë me statusin politik të Kosovës, të cilat tashmë janë të mbyllura. Do ta luftojmë korrupsionin. Do ta përkrahim funksionimin e shtetit juridik. Pa shtet të fortë juridik, ku pushteti legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor duhet të jenë të pavarur, nuk ka progres dhe demokraci të mirëfilltë. Do ta përkrahim shfrytëzimin efikas të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës. Do të bashkëpunojmë me organet e pushtetit tonë në forma të ndryshme. Do të angazhohemi në zbutjen e papunësisë së madhe. PSHDK do të angazhohet pëer një jetë më të mirë në Kosovë ku të gjithë do të trajtohen në mënyrë të barabartë, pa marrë parasysh kombin, religjionin apo veçoritë tjera.

4

Kryetari i PSHDK, Prof. Dr. Marjan Dema
Prishtinë, 25 qershor 2010

Blic Info

Njoftojmë opinionin publik se të gjithë shqiptarët me shtetësi austriake kanë rastin që për herë të parë, të votojnë një kandidat shqiptar: Januz Saliuka është nga Gjakova, jeton në Vjenë dhe është një ndër veprimtarët më aktiv të diasporës sonë. Pos tjerash, ai ishte përkrahës dhe shume aktiv edhe në PSHDK në Austri. Për me shume informacione lidhur me programin e tij zgjedhor mund ta kontaktoni direkt në:

Tel: 0043/(0)699 194 789 02

E-Mail: januz_saliuka@gmx.at

Shpërndajeni këtë informatë tek të gjithë miqtë tuaj në Vjenë, e sidomos tek ata që kanë të drejtë të votojnë në zgjedhjet e 10 tetorit 2010 për këshillin bashkiak të qytetit dhe landit të Vjenës. Si shqiptarë kemi rastin historik që të kemi përfaqësuesin tonë në Parlamentin e Vjenës. Mos ta lëshojmë këtë rast. Vota jonë për Januz Saliuken do të thotë votë për kultivimin e gjuhës, kulturës, të sotmes dhe të ardhmes tonë më të mirë në Vjenë. Ai është Zëri Yne. Votojeni!

E ARDHMJA E KOSOVËS

17 shkurti 2008 ishte data që shënoi kalendarin e historisë shqiptare, ngjarja më e madhe e kombit që pas 28 nëntorit 1912. Kjo datë ishte dita e triumfit të mirës ndaj të keqes, lirisë ndaj skllavërisë, humanizmit të botës perëndimore ndaj cenimit të drejtave themelore të jetës të botës lindore (Rusisë, Kinës, Koresë, Kubës, etj). Sakrifika e popullit ishte e madhe saqë dhamë gjithçka për të arritur këtë ditë, Rruga ishte e vështirë, që nga protestat e punëtorëve në vitet e 80 e deri me luftën për mbijetesë të popullit tonë. Gjatë kësaj rruge ne fituam simpatinë e një popujve paqedashës dhe liridashës nga perëndimi i qytetuar dhe bëmë shumë miqë në krye me ShBA. Pas luftës sonë për mbijetesë ne arritëm që në vitin 1999 të çlirohemi nga armiku shekullor dhe treguam se jemi të gatshëm të bëjmë miqësi me shtetet fqinje dhe të ndërtojmë një shtet demokratik. Organizuam votimet me të suksesshme në rajon për 9 vite me radhë, të lira dhe shumë transparente. Treguam gadishmëri bashkëqeversije me ndërkombëtarët dhe pas mbështetjes së SHBA dhe BE hymë në procesin e negociatave të ndërmjetësuar nga kryediplomati Marti Ahtisari duke treguar se jemi të gatshëm të bëjmë marrëveshje për liritë qytetare dhe ndërtimin e një shteti. Kjo gadishmëri sjelli deri te shpallja e Pavarësisë me 17 shkurt 2008 në bashkëpunim me miqtë perëndimorë. Por si duket realiteti i ri nuk ishte i mjaftueshëm që Serbia ta pranonte Kosovën si shtet. Ajo për dy vite me radhë u mundua që ta ndalojë procesin e njohjeve të Kosovës dhe të manipulonte me elementet nacionaliste në Kosovë për ta destabilizuar shtetin e ri dhe për ta humbur imazhin e shtetit më të ri në botë.

Edhe sa kohë do ta vazhdojë Serbia këtë politikë?

Gjatë 20 viteve të fundit kemi parë luftra në gadishullin ballkanik të inicuar pikërisht nga Serbia. Që nga Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia e duke e përfunduar në Kosovë. Athua deri kur populli serb do të jetojë në ëndrrat mesjetare të çlirimit të tokave ose luftës së shenjtë? Deri kur do të zgjasë sindromi i „Serbisë së Madhe” apo si duket në horizont ëndrrës serbe i ka ardhur fundi. Me vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë me 22 korrik 2010 pamë se Serbia bëri goditjen e fundit vetvetes, apo me mirë të themi „bumerangun” e radhës. Edhe pse ky proces u inicua pikërisht nga qeveria e Beogradit, doli që ishte në të mirën e Kosovës, çka neve na sjell në pozitë të kërkojmë njohje të reja dhe hyrje në bisedime për integrim në familjen evropiane. Ky vendim i dha një kapitull të ri shtetit tonë të ri në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Edhe pse kjo Serbisë i sjelli një goditje tani ata po mundohen që me një rezolutë në Asamblenë e OKB të sjellin një rezolutë për të ruajtur integritetin teritorial mbi Kosovën, Por kjo ndoshta do t'i sjell prapë një goditje vetvetes shteti jonë fqinj apo ndoshta qeveria e Beogradit po e bën hapin e fundit për t'i ngritur duart para popullit të saj duke thënë „ne bëmë gjithçka, por kundër gjithë botës s'mundem të bëjmë asgjë” dhe për ta pranuar realitetin e Kosovës shtet. Shtrohet pyetja: -A është e gatshme Qeveria e Kosovës dhe klasa politike e Kosovës t'i shfrytëzojë këto momente historike që po i ofrohen që të llobojë për njohje të reja? A është e gatshme qeveria jonë ta përgatisë rugën drejt afrimit për anëtarësimin në Bashkimin Evropian në planin e jashtëm, por edhe në planin e mbrendshëm të shtetit, të luftojë korrupsionin deri në nivelet qeveritare, të forcojë sistemin gjyqësor, të luftojë krimin e organizuar dhe të hartojë një plan të mirëfilltë për integrimin e pakicës serbe në Mitrovicë në gjirin e shtetit të ri. Unë mendoj se rruga po shkruhet, por sfidat po rriten. Që nga zbutja e varfërisë, krijimi i vendeve të lira të punës për të rinjtë tanë, thithja e investimeve dhe krijimi i një ambienti të sigurtë për këto investime do të ishte një parakusht dhe një mundësi e hapjes së Kosovës ndaj tregut të jashtëm.

Sfida e Radhës

Bisedimet me Serbinë të ndërmjetësuar nga BE besoj se do të fillojnë së shpejti, por tani do të kemi një përparsi, sepse tani përfaqësohemi si një shtet dhe bisedimet do të jenë në nivel shtetesh, çka do të thotë se bisedimet do të jenë teknike, marrëveshje bashkëpunimi dhe mundësi integrimi për serbet e Kosovës apo edhe pranimi i dokumenteve të udhëtimit nga Serbia. Tani është momenti që të ndërtojmë një miqësi me shtetet e rajonit dhe të thellojmë bashkëpunimin rajonal sepse edhe kjo pjesë e Evropës duhet që një ditë t'i takojë familjes së madhe evropiane. Rugës së gjatë po i afrohet fundi. A do të hyjmë në „paket” si Ballkan Perëndimor në Evropë apo do të jemi veq e veq si shtete kjo pak ka rënësi. Një gjë është e sigurtë: -Një ditë do të jemi edhe ne aty ku e kemi vendin. Tani është koha t'i harrojmë armiqtë, sepse ora kur edhe ne do të quhemi qytetarë evropian është afër. Të kujtojmë të kaluarën dhe ta ndërtojmë të ardhmen tonë do të jetë porosia ime për fund. Si konkluzion do ta citoj një fjalë të Presidentit John F. Kenedy " Forgive yours enemies but never forget their names" („Falni armiqtë tuaj, por kurrë mos jua harroni emrat”).

Skruan: Hazir Mehmeti, mësues dhe gazetar në Vjenë



KU E GJEN VETEN INTELEKTUALI YNË?

Nuk janë të pakët intelektualët në mërgatë. Ata i gjen të punësuar në punët nga më të ndryshme. Shumica tyre janë të pasivizuar dhe nuk çajnë shumë kokën për aktivitete kulturore që do kishin rëndësi për mërgatën dhe vet individin si pjesë e tij. Kështu është edhe në Vjenë e cila është e njohur si qytet kulturor i shumë kombeve, por jo edhe atij shqiptar. Që nga kohët e kaluara këtu vepruan figura të njohura të kulturës e historisë sonë: Norbert Jokli, Eçrem Çabej, Lasgush Poradeci, Aleksander Mosiu, Hil Mosi, Hasan Prishtina etj. të cilët lanë gjurmë me veprimtaritë e tyre në historinë e kulturën tonë. Në Vjenë ata formuan shoqata, botuan gazeta, bënë diplomaci e biznes. Kjo tregon se kishte komunikim edhe pse për dallim nga tani nuk ishte i lehtë. Njëra nga vlerat që ne i trashëguam nga këta veprimtarë e patriotë ishte pa dyshim gazeta „Djalëria” në të cilën botuan punimet e tyre shkrimtarët e veprimtarët tanë . „Djalëria” e cila vitin që lamë pas duhej të festonte nëntëdhjetë-vjetorin e saj. Këtë vlerë do thosha kolosale për gjenerata, të cilat e kanë detyrim kombëtar ta ruajnë e avancojnë më tutje dhe atë pikërisht njerëzit e artit e pendës dhe veprimtarët tjerë. Nga ajo që është e njohur kjo nuk është përmbushur as përafërsisht kur dihen mundësitë e krijuara tani. Organet vendore ishin dashamirëse të ruajtjes së vlerave të trashëguara duke e përkrahur në shumicën e rasteve edhe materialisht. Numri i studentëve dhe intelektualëve në Vjenë u rrit vazhdimisht. Rrethanat politike e materiale më të favorshme e mundësojnë këtë, por mungon organizimi ynë i mirëfilltë. Intelektualët tanë në Vjenë nuk kanë hapësirën ku do takoheshin dhe merrnin iniciativa konkrete, informata të ndërsjella lidhur me rrjedhat në përgjithësi e të kulturës në veçanti. Mungon një vend ku do njiheshim me talentet e rinj nga të gjitha fushat, ku do organizoheshin prezantime të krijimeve nga shkenca, arti e kultura.

Disa nga intelektualët bënë përpjekje për jetësimin e shoqatës së intelektualëve. Ajo u themelua menjëherë pas luftës por si duket vetëm emrin e mori të tillë kurse programi dhe veprimtaria e saj ishte jo ekskluzive për intelektualët. Po ashtu thuhet e shkruhet se ekziston Instituti i Kulturës dhe Artit Shqiptar në Vjenë të cilin e udhëheqë një piktor i njohur shqiptar, por shumica prej nesh këtu në Vjenë nuk dinë për selinë e as për ndonjë aktivitet të tij. Ndoshta mungon informimi i mërgimtarëve ashtu siq ndodh zakonisht në raportet mes nesh. Dy shoqatat studentore nuk janë aq të organizuara dhe të afta që të përfshijnë në aktivitetet e tyre një masë më të madhe intelektualësh jashtë rrethit të tyre studentor, bile do thosha as atë studentor. Nga ajo që dihet nga aktiviteti i tyre më e udhës do ishte ta kemi një shoqatë studentore të fuqishme e jo dy të ngathëta.

Intelektuali ynë është pjesë e mërgatës, andaj jo organizimi adekuat i saj e bënë pjesë të saj: jo i shfrytëzuar për nevojat tona në përgjithësi e në atë të kulturës në veçanti. Po të organizoheshim në formë lobi me program gjithëpërfshirës ku do ta ndiente secili pjesë e tij, do krijoheshin rrethana ku do i hapej rruga aktiviteteve, ku do vini në shprehje talentet e reja në të gjitha fushat e të cilët në Vjenë nuk mungojnë. Përkundër potencialit të mjaftueshëm njerëzor e material aktivitetet kulturore janë mjaftë të pakta. Tani mezi organizohemi në shënimin e festave me rëndësi kombëtare në nivel të përfshirjes së të gjithë mërgimtarëve nga të gjitha shtresat, gjë që dikur, edhe pse kushtet ishin më të pafavorshme kjo bëhej. „Tani i kemi dy ambasada shqiptare dhe pjesërisht e treta dhe nuk mund të koordinohemi”-kështu dëgjon të shprehen shumë njerëz tek të cilët ekziston bindja se tani e tërë kjo bie mbi ambasadën e personelin e saj. Kjo është e gabuar dhe shërben vetëm si mbulojë e mospunës dhe mosfunksionimit të shoqatave e partive politike të caktuara. Partitë politike e kanë humbur peshën e tyre së vepruari ilegalisht në vend tjetër. Ato edhe ashtu si ishin dikur në „zenitin” e tyre shkaktuan mjaftë përçarje në mesin e mërgimtarëve tanë punëtorë të cilët e mbajtën gjallë çdo aktivitet me rëndësi kombëtare gjatë gjithë historisë sonë të vjetër e të re. Kjo masë kërkon ofertë të aktiviteteve të mirëfillta nga kultura shqiptare. Asaj nga klubet e kafenetë po i ofrohet jo kulturë, të cilat si parësore e kanë vetëm fitimin e parave . Ndaj kësaj duhet reaguar dora vepruese e intelektualëve tanë në ofrimin e vlerave të artit e argëtimit me bazë kombëtare. Ata e kanë obligim njerëzor afirmimin e vlerave kombëtare para të tjerëve dhe njeriut tonë punëtor në mërgim. Kjo do kishte vlerë të pa llogaritshme në veçanti tek gjenerata e re e cila kërkon identitet në rrugëtimin e integritet në shoqërinë ku jeton.

Intervista: Ju prezentojmë ... studentin e dalluar: Vilson Kola



Vilson Prend Kola u lind më 1 maj 1985 në fshatin Sopot të Gjakovës. Shkollën fillore e kreu në Novosellë të Ulët, ndërsa shkollën e mesme të mjekësisë në Gjakovë. Filloi studimet në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës dhe pas një semestri i vazhdoi ato në Universitetin e Mjekësisë në Vjenë.

Z. Kola, si është të jesh student kosovar në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Vjenës?

Krahas kënaqësisë dhe krenarisë, ky status bart edhe një përgjegjësi të madhe mbi vete, pasi popull ynë është prezantuar në shumicën e rasteve si popull i lidhur shumë me krimin dhe trafikimin e qenieve njerëzore, kështu që na mbetet neve, njerëzve që kanë kontakte me inteligjencën austriake ta dëshmojmë të kundërtën dhe mos ta lëmë vetëm ambasadën tonë të merret me përmirësimin e imazhit të kosovarëve në Austri.

Cilat janë vështirësitë e para me të cilat jeni ballafaquar pas ardhjes tuaj në Austri?

Barriera e parë me të cilën përballesh në një vend të huaj është gjuha. Por përveç gjuhës kam pasur edhe vështirësi organizative: cilin kurs të gjuhës duhet ta vijoj, cilat janë të drejtat e mia si student, etj, pasi që studentët në Austri kanë një trajtim paksa me të veçantë se personat tjerë sa i përket çmimeve të udhëtimit si dhe vetë adoptimin në një shoqëri të re, edhe kjo nuk është aq e lehtë sa duket.

Keni pasur ndonjëherë ndjenjën se jeni i diskriminuar vetëm pse jeni i huaj?

Jo asnjëherë. Nuk mund të them se jam ndjerë i diskriminuar. Për këtë jam shumë falënderues gjithë shoqërisë austriake. Përkundrazi gjithmonë më kane përgëzuar dhe më kanë inkurajuar të vazhdoj më tutje.

Cilat janë eksperiencat tuaja me gjuhën gjermane? Në cilën kategori të gjuhëve do ta klasifikonit, në të lehta apo të rënda?

Personalisht nuk kam pasur vështirësi të mëdha me gjuhën gjermane. Mirëpo nga ana tjetër nuk mund të them se është gjuhë e lehtë. Para së gjithash gramatika dhe artikuljt e gjuhës gjermane, të cilat jo gjithmonë kanë rregulla të caktuar, rregulla të cilat do ta bënin më të lehtë përdorimin e tyre. Me artikuljt kam probleme edhe sot e kësaj dite ;-)

Sa është e rëndësishme përkrahja e familjes dhe të afërmeve për një përfundim të suksesshëm të studimeve në Austri?

Mendoj se kjo është pyetja me e rëndësishme e gjithë kësaj interviste! Pa mbështetjen e familjes do të ishte shumë e vështirë, të mos them e pamundur që t'i përfundoja studimet këtu në Austri. Me këtë nënkuptoj përkrahjen morale dhe materiale të tyre. Angazhimet në fakultet janë aq të mëdha sa të mbetet shumë pak kohë e lirë. Edhe nëse këtë kohë e shfrytëzon për punë nuk do të mjaftoj për vetëfinancim, kështu që detyrohesh të marrësh më shumë kohë nga studimet për të punuar dhe kjo qon në zgjatjen e kohës së studimeve dhe në uljen e suksesit në to.

Sa jeni të kënaqur me aktivitetet e ofruara nga shoqatat dhe partitë shqiptare në Vjenë?

Me herët nuk kam pas shumë kontakte me këto organizata, për shkak të mungesës së kohës, jo për tjetër arsye. Që nga pranvera e këtij viti jam aktiv në radhët e Partisë Shqiptare Demokristiane, në rolin e sekretarit të kësaj partie për Austri. Deri më tani jam shumë i kënaqur me angazhimet e kësaj partie, pasi që nga fillimi i aktivitetit të saj në Austri ka qenë me të vërtete si një diell për bashkatdhetarët tanë, të cilët shumë pak e kanë ndjere ngrohtësinë e këtij dielli, për shkak të mungesës së një shteti si dhe të rrethanave tjera tashmë të njohura.

Sa mirë janë të organizuar studentët shqiptarë në Austri, dhe cilat janë kontaktet tuaja me studentet tjerë në Vjenë?

Kam shumë kontakte me studentë kosovarë që studiojnë në Vjenë, dhe këto kontakte janë më shumë të natyrës shoqërore dhe kolegjiale. Shkëmbejmë mendime lidhur me procesin e studimeve dhe mendohe mi t'i ndihmojmë njëri-tjetrit gjatë kohës së provimeve. Për mendimin tim, studentët kosovarë këtu janë mirë të organizuar duke pasur parasysh kushtet dhe angazhimet që ata i kanë, mirëpo gjithmonë ka vend për një organizim më të mirë.

Cila do të ishte „receta” për një integrim të mirë të huajve në shoqërinë austriake?

Për mendimin tim, për realizimin e çdo procesi është shumë i rëndësishëm vullneti. Për fat të mirë neve shqiptarëve nuk na mungon ky vullnet, mirëpo më besoni se ka shumë shoqëri të huaja të cilat nuk duan aspak të integrohen në shoqërinë austriake. Pastaj vjen gjuha si një element shumë i rëndësishëm, pasi pa gjuhë nuk mund të integrohesh edhe nëse dëshira nuk mungon.

Cilat janë planet tuaja pas diplomimit?

Dëshira ime do të ishte që të ekzistonte një plan nga qeveria jonë për integrimin e studentëve të cilët kanë studiuar në vendet perëndimore. Mirëpo në mungesë të tij duhet që secili të gjej veten në Austri ose në ndonjë vend tjetër.

Cila do të ishte porosia juaj për studentët dhe studentet kosovare?

Ne kemi një rini shumë të etur për dije dhe për sukses, gjë të cilën nuk e kanë gjithë kombet tjera dhe porosia do ishte shumë e thjeshtë: mos pushoni së punuari deri sa të arrini realizimin e ëndrrave tuaja sepse çdo gjë mund të arrihet me punë dhe me vullnet.

Intervistoi: Anita Marku

SËMUNDJA E SHEQERIT

Diabetes mellitus ose **Sëmundja e sheqerit** është emërtim për një grup sëmundjesh metabolike dhe përshkruan simptomën e tyre kryesore: jashtëqitjen e sheqerit përmes urinës. Aparati i tretjes zhbën karbohidratet e marra me ushqim (nga frutat, patatet, orizi, misri) në sheqer. Ky sheqer pastaj kalon përmes murit të zorrëve në gjak dhe kështu shpërndahet në të gjithë trupin. Pankreasi prodhon në të ashtuquajturat “qelizat beta” të ishujve Langerhans hormonin **Insulin**. Insulin nxit të qelizat transportin e sheqerit në brendësi të qelizës. Në qeliza shfrytëzohet sheqeri për prodhimin e energjisë (Glikoliza). Insulin stimulon marrjen e sheqerit në qelizat trupore për prodhimin e energjisë si dhe me qëllim të ruajtjes së sheqerit në formë të Glykogenit në mëlqi dhe në qelizat muskulore. Niveli i sheqerit në gjak pas ngrënjes mbahet në kufi të ngushtë konstant (80-120 mg/dl ose 4,5-6,7 mmol/l). Edhe pas një periudhe të gjatë mosmarrjeje të ushqimit niveli i sheqerit në gjak është në vlera normale. Për këtë përkujdeset mëlqia: nga njëra anë zhbën Glykogenin dhe liron sheqerin në gjak, nga ana tjetër prodhon vazhdimisht sheqer të ri (Glukoneogjeneza). Nëse qelizat beta nuk prodhojnë Insulin, ose prodhojnë në sasi të pamjaftueshme, ose për shkak të inflamimeve apo operacioneve nuk janë të pranishme, mungon si transportimi i sheqerit në qeliza ashtu edhe pezullimi i prodhimit të sheqerit në mëlqi (kjo mund të prodhojë deri në 500 gram sheqer në ditë). Ky prodhim spjegon edhe ngritjen e nivelit të sheqerit në gjak te diabetikët p.sh. në mëngjes herët esëll. Për vendosjen e diagnozës së diabetit nevojiten të paktën dy matje të sheqerit në gjak ku niveli i tij është i lartë Diabeti, para së gjithash Diabeti Tip 2 është bërë një sëmundje masive e shpërndarë në tërë botën. Në vitin 2010 nga kjo sëmundje janë të prekur rreth 285 milion njerëz (6,4 % e popullsisë botërore).

-Diabeti Tip 2.- këtu kemi të bëjmë me një pengesë, ku Insulina është e pranishme, mirëpo nuk mund t'a arrin efektin e saj në membranat e qelizave (Insulinrezistencë). Në vitet e para të sëmundjes pankreasi mund ta kompensojë këtë problem duke prodhuar më shumë Insulin. Me kalimin e kohës Pankreasi nuk mundet ta mbajë këtë nivel të lartë të prodhimit të Insulinës. Atëherë sasia e prodhuar e Insulinës nuk është e mjaftueshme për ta kontrolluar nivelin e sheqerit në gjak dhe vjen deri te manifestimi i Diabetit Tip 2. Një i sëmurë nga Diabeti Tip 2 prodhon shumë më shumë Insulin sesa një person me metabolizëm normal (Hyperinsulinismus), por për shkak të një rezistence të rritur të Insulinës rritet sheqeri në gjak te këta pacienta. Shumë pacientë me Diabet Tip 2 për vite të tëra nuk kanë shenja të prekshme të kësaj sëmundjeje. Për dallim nga Diabeti Tip 1, Diabeti Tip 2 shumë rrallë shoqërohet me rënie në peshë dhe vetëm te rritjet massive të sasisë së sheqerit në gjak manifestohet me shtim të urinimit dhe të etjes. Në fillim shpesh paraqiten shenja jospesifikë si lodhje, plogështi, pengesa në të pamur dhe një afinitet më të madh ndaj infeksioneve si p.sh. infeksione të shpeshta të fshikzës urinare.

Mbipesha konsiderohet si një ndër shkaqet kryesore për këtë lloj sëmundjeje. Krahas rezistencës së lindur ndaj Insulinës rezulton nga mbipesha edhe një rezistencë shtesë për qelizat që varen nga Insulina. Mirëpo faktor vendimtar është predispozita gjenetike, ku me gjasë shumë gjene janë të përfshira (sëmundje poligjenike). Një tjetër faktor te kjo sëmundje është një prodhim i shtuar i sheqerit (Glykoneogjenezë) nga ana e mëlqisë. Poashtu një sasi e lartë e Vitaminës D e përgjysmon rrezikun për një Diabet Tip 2. Te gratë që ushqejnë fëmijët e tyre me gji, ulet për cdo vit të dhënjes gji rreziku për tu sëmurë nga kjo sëmundje për 15 %.

Te Diabeti Tip 2 duhet të ulet rezistenca ndaj Insulinës përmes uljes së peshës dhe lëvizjeve më të shumta trupore gjatë ditës. Një terapi medikamentoze duhet të aplikohet pas shterrjes së këtyre masave. Gati gjysma e të gjithë të diagnostifikuarve me Diabet arrijnë përmes një humbje peshe prej 10 kg.

Sëmundjet përcjellëse të Diabetit Tip 2 janë: tension i lartë i gjakut 75,2 %, retinopati diabetike 11,9 %, Neuropati 10,6 %, infarkt i zemrës 9,1 %, apopleksi 4,7 %, dëmtim i veshkave 3,3 % etj.

Udhëpërshkrim:

SHËNIME NGA AUSCHWITZ-i

Pak para mesditës grupi ynë u nis drejt vendit ku 55 vite më parë barbaria njerëzore kishte dëshmuar se se e pavlerë mund të jetë jeta e njeriut. Treni përshkruante vijën gjarpërore, e cila si destinacion të fundit kishte fshatin Birkenau në Poloninë veriore i cili ëndërronte të bëhej i njohur për verën e kuqe dhe veshjet tradicionale kombëtare. Por jo. Fati i keq e deshi që bota ta njoh si Auschwitz, vendi ku u shkruan faqet më të errta të historisë së luftës së dytë botërore. Luftës së absurdit, çmendurisë, dhembjes dhe vuajtjes së madhe. Dy nga koleget tona austriake tashmë kishin vizituar vendin e tmerrit dhe thonin se i janë bashkangjitur grupit tonë vetëm e vetëm për të qenë me ne deri afër cakat, por nuk dëshironin që dhe një herë të shkelnin atë vend. Preferonin të qëndronin pak më larg, dhe ne nuk po arrinim dot të kuptonim esencën e kësaj ndjenje. Sidoqoftë, të gjithë premtuam të respektonim atë vendim.

Pohimi

Ish-kampi më i madh i përqendrimit në botë shtrihej në një hapësirë të rrafshhtë prej disa dhjetra hektarësh. Në hyrje, mbi portën e hekurt shkruante “Arbeit macht frei” („puna të bën të lirë”). Ciceroni na prin drejt së parës nga shtatë ndërtesat trekatëshe me tulla të kuqe. Që në hyrje zyrtësi. Në koridor kalojmë pranë fotografive të meshkujve dhe femrave nga të gjitha nacionalitetet. Në trup mbanin uniformat e burgut vija-vija. Në to secili kishte të gavruar nga një numër. Ata ishin emrat e tyre. Jetë e vdekje bashkë. Fillim e mbarim. Dhomat dukeshin të errta. Në shtetërit nga druri dhe mbuluar vetëm me kashtë, kishin bërë gjumin nga 4-5 persona, përderisa batanijet e baltosuar nuk mbulonin as gjysmat e trupave. Racioni ditor i ushqimit përbëhej nga një copë e hollë buke të fortë dhe një filgjan uji të zier që ngjante në çaj të mykur. Me qindra mijëra fëmijë, gra, burra e pleq, nga e tërë Europa, më së shumti hebrenj, polakë dhe romë, por dhe të tjerë kundërshtarë potencial të naziztëve ishin sjellur aty për të pasur këtë adresë të përbashkët. Përgjatë katër viteve më se 1, 1 milion njerëz gjetën vdekjen në këtë vend. Më pas vizituam dhomat e gazit dhe mbetjet e Zyklon B, pamë thasë të mbushur me flokë grash, sasi të mëdha të krehërve, çantave të dorës dhe një grumbull të madh këpucësh të fëmijëve: numër 17, 22, 25 ...Ishte e pamundur që para kësaj skene të qëndroje indiferent. Kësaj radhe të gjithëve na tradhëtuan lotët. Nga goja e ciceronit vazhdonin tregimet e tmerrit: për doktorin gjerman Josef Mengel të quajtur edhe „enjulli i vdekjes”, i cili ndante të ardhurit: majtas- ata që do vriteshin po atë ditë, dhe djathtas- ata që do jetonin dhe punonin dhe pak kohë, por që do vdisnin ca javë më vonë; për eksperimentet e kryera në foshnja në kërkim të „racës së pastër”, për udhëheqësin e kampit, Rudolf Höss, i cili pas çlirimit të kampit u zu, u gjykua dhe u var mu në hyrje të krematoriumit kryesor.

Mohimi

Kur në pranverën e vitit të kaluar në Gjenevë u mbajt konferenca ndërkombëtare mbi anti-racizim, ishte rast i mirë për presidentin e Iranit, *Ahmadinejad*, që të ngritet në foltore, dhe për të satën herë me radhë, të mohoj vuajtjet gjatë Holokaustit dhe minimizojë vdekjet e gjithë atyre që të vetmin faj kishin faktin se i përkisnin popujve që aq shumë e deshën lirinë. Më shumë se dhe vet jetën. Intelektualët dhe burrshtetasit i dolën përballë diktatorit mjekërrgri, por nuk arritën ta ndalnin dot të mohoj të mësoj nga historia dhe të luaj shah me vetveten, duke i ngritur himne krimin. Është e pafalshme që kjo ndodhë në këtë shekull, i cili do të duhej të ishte shekulli i paqes. Për më tepër, në kohën kur ende jetojnë të mbijetuarit e fundit të Auschwitz-it. Ata që tejkaluan vetveten dhe mbijetuan për të dëshmuar. Fjala e gjallë e njerëzve të vdekur.

Dolëm nga Auschwitz-i më të trishtuar se sa kur hymë. Të gjithë u pajtuam se më asgjë nuk të ishte si më parë. Se tani e tutje në jetë do kemi dhe një mision më tepër: kudo që jemi dhe çfarëdo që bëjmë: të mos lejojmë kurrë më që të përsëritet Auschwitz-i. Me asnjë çmim. Në emër të jetës, lirisë, solidaritetit dhe humanizmit. Në emër të njeriut. Këtë betejë nuk guxojmë ta humbim. Në dalje lexuam mbishkrimin „e keqja më e madhe pas Auschwitz-it është që të harrohet ai”. Vetëm pas këtij reflektimi, kuptuam se sa i vështirë do të jetë rikthimi në këtë vend për të dytën herë.

Përmbodhi: Zef Ndrecaj

Doli nga shtypi libri me titull „Tregime nga Malësia e Gjakovës" i Autorit Xhenc Bezhi

(promovimi i tij për Austri do të mbahet në Vjenë, të shtunën, me 4 shtator 2010 në ora 20:00 në Kishën e Misionit Katolik Shqiptar. Adresa: Meiselstrasse 1, 1150)

Kjo përmbledhje është i një rëndësie të veçantë ngase Gjakova si tërësi ka një bujëshmëri të veçantë të këtyre tregimeve që nga koha e lashtë e deri më sot. Odat e Gjakovës gjithmonë ishin burim i diturisë, traditës, qëndresës, bujarisë dhe fisnikërisë. Ato i qëndruan të gjitha kohëve, stuhive dhe rrëmujave dhe ishin kështjella të pathyera ku u mbajtën kuvende, u ndanë pleqëri qoftë në mbrojtje të atdheut, qofte pajtimeve apo zgjidhjes së çështjeve të ndryshme në rajonin e Gjakovës por edhe më gjerë. Ishin këto odat në të cilat edhe autori u lind dhe u kalit. Ndonëse ai jeton në perëndim pasioni i këtyre tregimeve mbeti në gjakun e tij. Ai tani para nesh nxori këtë vëllim me mjaft vlerë. Libri përmban 218 tregime të shtjelluara dhe shkruara me vet gjuhën e popullit, me vetë frymën e atij mjedisi ku edhe ato janë lindur. Veçanti e tërë asaj është se autori e jep të gjallë autoktoninë e kësaj ane, ashtu si ishte. Tiparet e njerëzve janë tipike dukagjinase-malësore ashtu siç ishte vet Malësia e Gjakovës dhe mu ato e bëjnë edhe më të pasur këtë krijimtari. Ai na jep të gjitha ato fjalë ashtu si kjo trevë i mbajti të gjalla. Të gjitha këto karakteristika që autori Xhenc Bezhi i përmbodhi pasurojnë shumë vlerën tonë krijuese, letrare dhe kombëtare. Kjo sidomos kur jemi dëshmitarë të asaj që ato dita ditës janë duke u zbehur. Falënderojmë autorin Xhenc Bezhi nga se me këtë përmbledhje ato do të mbesin për jetë të shkruara dhe kurrë të harruara .

Vlerësime mbi librin nga Prend Buzhala: Si dikur, edhe sot, shpesh anekdotat rrëfehen në biseda të përditshme nëpër ndeja shoqërore, në tubime, qofshin ato edhe me karakter politik apo kulturor. Anekdotat e Xhenc Bezhi i fshin kufijtë midis të djeshmes e të sotmes...nuk mbyllet brenda një hapësire tradicionale, as brenda një hapësire rurale apo urbane. Protagonistët e këtyre tregimeve, si rëndom, janë bashkëbisedues që e përfaqësojnë jo vetëm zërin e tregimtarit: ata janë edhe bashkëbisedues të angazhuar me problemet e shumta të realitetit jetësor, tek i vënë në thumb të metat e dukuritë negative. Rrëfimi i këtyre “tregimeve odash” është i larmishëm, po edhe i pasur e i motivuar. Ai nuk rrëfëhet vetëm “në odë”, kurse ngjarjen nuk merr vetëm “nga oda”. Përkundrazi, e merr nga manifestimet e shumta jetësore, nga çastet e gëzuara të jetës, sikundër janë dasmat, festat, lojërat, fejesat etj, po e merr edhe nga bisedat familjare e shoqërore. Këta bashkëbisedues janë, prandaj, edhe bariu dhe blegtori, baba dhe djali, nëna dhe vajza, dhëndri dhe vjehri, burri dhe gruaja, fqinjët dhe të afërmit, po edhe njerëzit e zejeve dhe mjeshtërive të ndryshme; ata ligjërojnë, rrëfejnë, vetërrëfehen dhe veprojnë. Së këndejmi, parakalojnë një galeri e pasur karakteresh, protagonistësh e bashkëbiseduesish. Parakalojnë fytyra të dalluara për nga urtia e mençuria, po edhe njerëz të njohur, apo bartës të ndonjë vesi apo të mete. Mjeshtëria e të treguarit, kurdoherë, do ta shquajë plasticitetin e rrëfimit, fuqinë e shprehjes, si dhe filozofinë popullore të ekzistimit. Veçoritë individuale njerëzore, puna, kursimi, përtacia, interesi personal, koprracia, ryshfeti, karakteret e ulëta njerëzore e të luhatshëm, vjedhja, gënjeshtria, xhelozia, mburrja, kryeneçësia, frika; po edhe zgjuarsia, sinqeriteti, drejtësia, këshillat; të gjitha së bashku do ta përbëjnë tematikën e gjerë të këtij vëllimi.

10

Vlerësime mbi librin nga Mustafë Rugova: Në këtë përmbledhje të titulluar “Tregime nga Malësia e Gjakovës” trajtohet mrekullisht filozofia e urtë si dhe humori i hollë nëpër odat e Dukagjinit nga baballarët tanë. Në secilën anekdotë, pa përjashtim do të gjejnë nektarin e atdhedashurisë, do të kenë mundësinë të shohin se sa me elekuencë e godasin armikun, do ta provojnë nga afër edhe atë këndshëm, se si dinë ta linçojnë atë që bashkëpunon me armikun, do të kënaqen deri në shastisje me humorin e klasit të parë. Sot, edhe pse kjo lloj filozofie është pakësuar në masë të madhe, prapë se prapë, sa herë që i lexon apo i dëgjon s’ke si mos të bëhesh shumë kureshtar për fonetikën e thekshme të baballarëve tanë, të cilët edhe pse ishin në një okupim klasik, e goditnin armikun dhe bashkëpunëtorët e tij sikur gjylja e topit. Ishin baballarët tanë, që ne i kujtojmë me krenari ata të cilët na e servuan këtë ushqim të shpirtit për të mos na lënë të lëngojmë nga ndonjë sëmundje e keqe e injorancës. I bindur që miku im Xhenci ka hyre në trajektoren e shkrimtarëve, ai nuk do të ndalet me kaq. Përkundrazi ai në të ardhmen do të na dhurojë edhe libra të tjerë, e sidomos në fushën poetike, ku ai shkëlqen më së miri. „Të paktë janë ata që kanë frymë vjershërie”, do të thoshe Faiku ynë, ndërkaq unë me një siguri të njëqind për qind e them, dhe atë me shume zë se Xhenc Bezhi ka hy lirshëm në kështjellën e vjershatorëve më të mirë!

Shënime për autorin:



Xhenc Bezhi lindi me 15 nëntor 1961 në Gjakovë. Shkollën e mesme e kryeu në „Hysni Zajmi” Gjakovë dhe pastaj diplomoi për gjuhë dhe letërsi shqipe në shkollën e lartë pedagogjike „Bajram Curri” në Gjakovë. Ka punuar në arsim dhe organizonte aktivitete të ndryshme sidomos përmes trupës së teatrit amator „Emin Duraku” në qytetin e lindjes. Me shkrime merret prej shkollës së mesme. Ka punime të botuara në shtypin periodik të asaj kohe dhe në revisten lokale letrare „Shtigje” të klubit letrar „Gjon Nikollë Kazazi” në Gjakovë. Prej vitit 1992 pa dëshirën e tij migron në Austri ku jeton edhe sot.

Historik i shkurtër i shoqatës „Nënë Tereza” në qytetin Baden afër Vjenës



Shoqata „Nënë Tereza” në Baden (Austri) u krijua me iniciativën e disa veprimtareve shqiptare me 31 mars 2009. Në takimin themelues morën pjesë shumë bashkëatdhetarë dhe në të pas diskutimeve të ndryshme, kryetare e shoqatës u zgjodh Hane Kola, nënkryetare Hidajete Turkaj, sekretare Drita Rushiti dhe arkatare Cube Turkaj. Me 4 nëntor 2009 u mbajt manifestimi i parë, ku morën pjesë përfaqësues të kuvendit komunal të Badeni-it, partive politike austriake si dhe qytetarë të shumtë shqiptarë dhe austriakë. Të ardhurat e mbledhura nga ky manifestim iu dërguan 3 familjeve me gjendje të rëndë sociale në Gjilan. Me 28 mars 2010 shoqata organizoi një koncert humanitar, në të cilin performoi këngëtari i njohur Malësori, ndërsa me 10 tetor të këtij viti shoqata do të jetë bashkëorganizatore e ceremonisë në të cilën veprimtares së njohur shqiptare Mihrije Rushani nga organizata austriake "Weltmensch" do t'i ndahet mirënjohja për aktivitetet e saj të deritashme humanitare. Në këtë organizim janë të ftuar përzemërsisht të gjithë bashkëatdhetarët në Austri.

Këndi kulturor:

Thënie dhe poezi nga Nënë Tereza

- Ne s'mund të bëjmë dot gjëra të mëdha, vetëm gjëra të vogla me dashuri të madhe
- Nuk ka rëndësi sa shumë jemi të angazhuar të bëjmë, por sa shumë dashuri vëmë, në atë që bëjmë
- Sa më tepër kemi, aq më tepër jemi të zënë, aq më pak japim. Por sa më pak kemi, aq më të lirë jemi, aq më shumë japim. Varfëria për ne është liri. Nuk është turp. Është liri e gezueshme.
- Përpara se të flasim është e nevojshme të dëgjojmë, se Zoti flet në heshtjen e zemrës
- Nëse vërtet duam të duam, duhet të mësojmë si të falim!
- Follu butësisht njerëzve! Tregoje mirësinë në fytyrë, në sy, në buzëqeshjen tënde, në ngrohtësinë e buzëqeshjes tënde, gjithnjë të kesh buzëqeshje gazmore! Jep jo vetëm kujdesin, por edhe zemrën!
- Në qoftë se je i përlurur, asgje nuk të prek, as lëvdim, as turp, sepse ti e di mirë kush je

11

GJEJ KOHË...

Gjej kohë të mendosh
Gjej kohë të lutesh
Gjej kohë të qeshësh
Është burimi i fuqisë
Është fuqia më e madhe mbi tokë
Është muzika e shpirtit.

Gjej kohë për të luajtur
Gjej kohë të duash dhe të duhesh
Gjej kohë të japësh
Është sekret i rinisë së përjetshme
Është privilegj i dhënë prej Zotit
Dita është shumë e shkurtër për të qenë egoistë.

Gjej kohë të lexosh
Gjej kohë të jesh mik
Gjej kohë të punosh
Është burim mençurie
Është rruga e lumturisë
Është çmimi i suksesit.

Gjej kohë të bësh mirësi
Është çelësi i parajsës.

(Nënë Tereza)